




Prishtine, data: 18.05.2021

KOMISIONI I PAVARUR PER MINIERA DHE MINERALE - Ne baze të Ligjit me nr.05/L-031 te procedurës se përgjithshme Administrativë dhe Udhëzimit Administrativë me nr.001/2018 mbi Procedurat e Qarkullimit te Dokumenteve, skanimi dhe ruajtje e tyre – arkivimi elektronik, në lidhje me aktvendimin me numër te protokollit 2121 dt. 30.07.2012 mbi shqiptimin e gjobës administrative ndaj: **Sadik Krasniqi** person fizik, me adresë; Krushë e Madhe Rahovec, merr këtë vendim :



AKTVENDIM

1. Dorëzimi i mëtejshme i te gjitha shkresave dhe parashtresave për **Sadik Krasniqi** person fizik, me adresë; Krushë e Madhe Rahovec, tani e tutje do te behet me afishimin e tyre ne tabelën e shpalljeve ne Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale .
2. Komunikimi nga pika I e dispozitivit konsiderohet i kryer, pas kalimit te afatit prej 10 ditëve, nga dita e afishimit te tyre ne tabelën e shpalljeve ne Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale .

Arsyetim

Ndaj **Sadik Krasniqi** person fizik, me adresë; Krushë e Madhe Rahovec, KPMM ka leshuar aktin administrativ me nr. 2121 dt. 30.07.2012.

Ne tentim qe t'i dorëzohet akti administrativ përputhje me nenin 7 par. 3 te Udhëzimit Administrativë me nr.001/2018 , nga fletë kthesa e kthyer nga posta dy herë me dt. 30.07.2012 dhe me dt.19.03.2021 është konstatuar se pala nuk e ka pranuar aktin administrativ. Andaj, në pajtim me nenin 7.3.13 bëhet shpalljen publike të këtij akti administrativ.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi administrative .



Ramiz Krasniqi
Drejtor
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale



Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosovo

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale
Independent Commission for Mines and Minerals



Prishtinë, 26.07.2012

Në pajtim me nenin 79 paragrafin 4 të ligjit nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minerale,
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale nxjerre këtë:

AKTVENDIM

Ndaj Sadik Krasniqit person fizik, me nr. të telefonit 044/121-257 me adresë fshati Krushë e Madhe komuna e Rahovecit.

1. Në pajtim me nenin 79 paragrafi 4 ju shqiptohet gjoja administrative për zhvillimin e aktivitetit ilegal, pa Lejen për Aktivitete të Veçanta- Seperacionin në shumë prej 5,000.00€ .

Arsyetim

Gjatë inspektimit të operimeve ilegale me datën 07.06.2012, personi fizik Sadik Krasniqi është hasur duke operuar ilegalisht në përpunimin dhe seperimin e resurseve minerare. Inspektimi është bërë në lokacionin i cili gjendet në fshati Krushë e Madhe, komuna e Rahovecit. Inspektoret e Minierave kanë konstauar se lloji mineralit që ju e seperonit ishte rërë dhe zhavorë. Në ditën e inspektimit ju është udhëruar me anë të urdhëresës për ndërprerje të aktivitetit ilegal të leshuar nga Inspektoret, që menjëher të ndërpreni aktivitetin e paligjshëm.

Makineria me të cilat ju zhvillonit aktivitetin ilegal të seperimit dhe përpunimit të lëndes minerare përbëhej prej: Seperacionit të reres dhe zhavorit; dhe Lugës ngarkues e tipit Libeherr 541.

Inspektoret e Minierave kane konstatuar se personi fizik Sadik Krasniqi aktivitetin e operimeve ilegale e zhvillonte në lokacionin me këto kordinata Y= 7468653, 7468661, 7468644, 7468619; X= 4685478, 4685461, 4685439, 4685459; Z= 321, 321, 321, 321, për të cilat kordinata nuk posedoni Leje për Aktivitete të Veçanta-Seperacion të leshur nga KPMM.


Afati për kryerjen e pagesës së gjobës administrative është 15 ditë nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, pagesa e faturës bëhet në Bankën Qendrore të Kosovës në këtë xhirollogari 1000430070005950. .

Duke marrë parasysh arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Aktvendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij nga Drejtori i KPMM.

Rr. Armend Daci Nr.1
Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (38) 240 252
Fax: +381 (38) 245 844
E-mail: ICMM@kosovo-mining.org
Web: www.kosovo-mining.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo




Këshilla Juridike: Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa duke ju drejtuar Komisionit për Ankesa pranë KPMM-së në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi

Ankesa kundër këtij aktvendimit nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit sipas nenit 128 par.(a) të Ligjit për Procedurën Administrative.

Aktvendimi t'i dergohet:

Arkivesë së KPMM-së,
Departamentit të Financave të KPMM-së,
Palës


Selvetë Grajqevci Pllana
U.D e Drejtorit
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale